



**QENDRA MEMO**

**Autoriteti për Informimin mbi  
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

Nr. \_\_\_\_ Prot. Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

Nr. 212/1 Prot. Datë 10.1.2020

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

E lidhur sot, më datë \_\_\_\_\_.2020, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit,**

dhe

**2. Qendra MEMO – Tiranë (i quajtur në vijim MEMO), e përfaqësuar nga znj. Ema Andrea, Drejtore Ekzekutive e MEMO.**

Palët janë marrë vesh se për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

### **Neni 1**

#### **Objekti dhe qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të formalizojë bashkëpunimin në fushën e kujtesës përvlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe për të kontribuar në realizimin e projekteve të memories.

Bashkëpunimi institucional ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe MEMO-s ka për objekt:

- Vendosjen e një bashkëpunimi të frytshëm në kuadrin e projekteve të kujtesës, si ndihmesë në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, në përpjekje me misionin dhe fushën e përgjegjësisë të të dyja palëve.
- Angazhimin e MEMO-s në studime, mbledhje faktesh, mbledhje fondesh, fushata sensibilizuese, monitorime dhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuese dhe trajnuese të organizuara nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

- Ndihmën në inicimin e akteve ligjore për realizimin e muzeve të kujtesës; në fushata sensibilizuese dhe mbështetëse për çështjet me rëndësi publike;
- Organizimin e aksioneve konkrete për të mbrojtur të drejtat e njeriut të shprehura me ligj, etj.

### **Neni 2 Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj Marrëveshjeje është ligji nr. 45/2015 “*Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, neni 17 i Rregullores “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit*”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2017, Rezoluta nr.11 “Për dënimin e kimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e kimeve te komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjojen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016) të Kuvendit të Shqipërisë, Rezoluta e Parlamentit European mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit European të Kujtesës dhe Solidaritetit.

### **Neni 3 Detyrimet e Palëve**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit merr përsipër:

- Në varësi të projekteve dhe mundësive financiare, t'i kërkojë MEMO-s angazhimin në kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me kujtesën historike në interes të publikut, studiuesve dhe programeve të edukimit shkollor; aktivitete të ndryshme studimore, kërkimore-shkencore, trajnime, seminare, simpoziume, forume, fokus grupe për çështje ad hoc duke përfshirë edhe familjarët e viktimave të kimeve të komunizmit, etj;
- Të promovojë, sipas mundësisë, dhe të përmendë në aktivitetet që organizon dhe/ apo merr pjesë, bashkëpunimin me MEMO-n duke përfshirë logon e tij kurdoherë që është e mundur.
- Të mirëpërdorë fondet e mbledhura nga MEMO, për realizimin e projekteve të kujtesës, apo veprimtarive të tjera me natyrë të ngjashme duke përcaktuar edhe një procedurë të veçantë të dakordësuar nga të dy palët për këtë qëllim.

MEMO merr përsipër:

- Të kryejë shërbime në funksion të realizimit të projekteve në lidhje me memorien historike në të mirë dhe në interes të publikut;
- Të ndihmojë në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me kujtesën historike;



- Të iniciojë aktet ligjore që nevojiten për realizimin e muzeve të kujtesës dhe objekteve të tjera me natyrë të ngjashme, si dhe studimin e thelluar të ngjarjeve historike e individëve të lidhura me ta;
- Të organizojë studime, anketime, konferenca, seminare, trajnime mbi çështjet me rëndësi publike dhe/apo me qëllimin e punës së përbashkët me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- Të mbledhë fonde për realizimin e projekteve të kujtesës, për fushata të ndryshme sensibilizuese dhe programe të edukimit qytetar për demokraci;
- Të organizojë aksione konkrete për të mbrojtur të drejtat e njeriut, të shprehura me ligj;
- Të inkurajojë studime të thelluara të ngjarjeve historike dhe individëve të lidhura me projekte muzeale, kujtese, të rishqyrtimit të historisë apo edukimit qytetar, si dhe të nxisë implementimin e rezultateve të kërkimeve shkencore të reja historike në programin e edukimit shkollor.

MEMO dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit marrin përsipër të bashkëpunojnë për:

- Realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e memories historike.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si forume, seminare, trajnime, konferenca, simpoziume, blogje, duke inkurajuar organizimin e tyre në të mirë dhe interes të publikut, sipas kalendarit të kujtesës dhe planeve përkatëse vjetore të shkëmbyera.
- Shkëmbimin e informacioneve në lidhje me veprimtarinë e secilës palë, për çështje që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër sipas një plani paraprak të dakordësuar paraprakisht nga të dy palët.
- Bazuar në Platformën Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes përsa i përket transparencës së fondeve të përdorura gjatë këtij bashkëpunimi: AIDSSSH dhe Qendra MEMO, duke qenë subjekte që punojnë me të njëjtin qëllim dhe me të njëjtat objektiva përsa i përket zbardhjes së historisë dhe të krimeve të diktaturës komuniste në Shqipëri, marrin përsipër të bëjnë transparencën reciproke të fondeve të përdorura në çdo moment që të kërkohet nga njëri prej subjekteve. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe përgjigjja që mban zbardhjen e përdorimit të fondeve për subjektin kërkues duhet të jepet jo më vonë se një muaj nga momenti i marrjes së kërkësës në fjalë. Kërkesa për zbardhje dhe transparencë të fondeve nuk duhet të përfshijë një periudhë më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

#### **Neni 4** **Pronësia intelektuale**

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

Palët i jatin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi, dhe planeve vjetore të shkëmbyera. Në çdo rast, secila palë do të përdorë materialet e palës tjetër duke cituar burimin e informacionit.

Në raste të tjera të kërkësave studimore të MEMO-s aplikohet tarifa e vendosur me ligj.

## **Neni 5 Kufizimet/Garancia**

- 1- Palët bien dakord që nuk do të ketë ndërhyrje në aktivitetet e secilës Palë të cilat nuk janë realizuar si rezultat i këtij bashkëpunimi.
- 2- Të dyja palët nënkuptojnë se ata nuk mund të përdorin ndonjë imazh ose përshkrime të dëshmive, intervistave, filmave, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen Palës tjeter ose këtij bashkëpunimi në mënyrën që imponon miratimin ose sankzionimin nga ana e Palës tjeter ose të aktiviteteve të tyre.
- 3- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit bie dakord që vullat e **MEMO**, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë të cilat mund të janë të pranishëm në faqen e internetit të AIDSSH, nuk do të keqpërdoren nga AIDSSH në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e AIDSSH janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar nga **MEMO**, si dhe nuk do të përdoren si fakt për të qenë superior ndaj ndonjë produkti apo shërbimi tjeter si dhe anasjellas.

## **Neni 6 Shpërndarja e materialeve**

Materialet e mbledhura dhe të krijuara rishtas si rezultat i bashkëpunimit, mund të transmetohen anembanë botës në platforma të shumëfishta të transmetimit, nën siglën **MEMO** dhe **AIDSSH**, që kanë autoritetin përfundimtar redaktues për të gjitha materialet e shpërndara për transmetim apo publikim.

AIDSSH nuk mban përgjegjësi për interpretimin e materialeve që vë në dispozicion dhe në çdo rast distancohet nga gjuha eurrejtjes në trajtimin e tyre.

Materialet e **MEMO** dhe **AIDSSH** mund të referohen në mënyrë të ndërsjellë nga palët, në faqet e tyre zyrtare dhe zyrat përkatëse.

## **Neni 7 Komunikimi**

Secila palë do të caktojë një person kontakti, përgjegjës për të bashkërenduar aktivitetet e Marrëveshjes, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Personi përkatës u komunikohet palëve respektive të kësaj marrëveshjeje brenda javës së parë pas firmosjes së saj.

## **Neni 8 Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat**

1. Palët mund të bëjnë përmirësim, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesa do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **MEMO**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.



**Neni 9**  
**Mirëbesimi**

1. **AIDSSH** dhe **MEMO** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënrat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitet e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

**Neni 10**  
**Afati i marrëveshjes dhe zgjidhja e saj**

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë dyvjeçare.
2. Marrëvesha mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përbahen detyrimeve të rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përparrat datës së përfundimit të saj.
4. Shkelja e dokumentuar e njërsës prej pikave të marrëveshjes, përbën një arsyë të ligjshme për zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje, e cila mund bëhet me informimin e njëanshëm nga subjekti që konstaton shkelje flagrante dhe të dokumentuar të palës tjetër.


**Neni 11**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëvesha është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në depozitohen në **MEMO**.

**QENDRA MEMO**



**Autoriteti për Informimin mbi  
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**



*MJ*